



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health**

**Departamenti Shëndetësor i Burgjeve**

**RAPORT PËRMBLEDHËS I AKTIVITETEVE TË DSHB PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2023**

I nderur zoti Ministër, Vitia,

Departamenti shëndetësor i burgjeve, bazuar në planin e punës për vitin 2023, buxhetin e aprovuar, stafin që posedon, përpjekjet për zbatimin e Praktikave Standarde të Veprimt, konform Rekomandimeve të Këshillit të Evropës, Projektit me KE, rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera relevante të fushës ka kryer aktivitet e parapara sipas planit të punës dhe indikatorëve shëndetësor të paraqitur gjatë kësaj periudhe.

Në këtë raport shkurtimisht janë prezantuar aktivitet e gjithmbarshme të shërbimeve shëndetësore në NjShB dhe DShB, përpunimi i të dhënave dhe krahasimi i tyre me ato të gjashtëmujorit të vitit të kaluar.

Është paraqitur në mënyrë të veçanet të dhënat epidemiologjike, indikatorët specifik, monitorimi dhe raportimi i NjShB, menaxhimi i buxhetit dhe proceduarve të prokurimit, shëndeti mendor në burgje dhe specifikat, trajtimi sëmundjeve të varësisë dhe metadoni, specifikat e popullacionit duke potencuar sëmundjet kronike, geriatrike dhe ato psikiatrike, IShTPNV, kushtet higjienike sanitare në burgje dhe DDD, barërat dhe menaxhimi i tyre, zbatimi i SISH, Projekti i KE, bashkëpunim i me ShKK/MD, MKPT të IAP dhe institucione të tjera si dhe vështirësitë dhe synimet.

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur indikatorët që përcaktojnë aktivitete kryesore shëndetësore në kuadër të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve – DShB:

Disa indikatorë të DShB, Janra -Qershor 2023		Muajit						Totali, 6 mujori i parë 2023	Totali, 6 mujori i parë 2022
Nr	Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor		
1	Te burgosur te pranuar	553	389	475	365	422	345	2549	2434
2	Te burgosur te liruar	406	358	423	347	427	344	2305	2286
3	Vizita e pare mjekesore ne pranim	553	389	475	365	416	345	2543	2432
4	Konsulta mjekesore	2794	2271	2505	2597	2784	2412	15363	14521
5	Konsulta psikiatrike	596	591	516	456	583	447	3189	3368
6	Konsulta psikologjike	829	558	751	554	651	564	3907	3618
7	Sherbime dentare	312	252	275	174	309	273	1595	1628
8	Sherbime te tjera mjekesore	2392	1898	2083	2133	2182	1975	12663	8609
9	Totali i konsultimeve shendetesore	6324	5041	5135	5295	5715	4898	32408	29905
10	Hospitalizime ne Stacionarin e burgut	16	7	9	8	13	11	64	71
11	Hospitalizime ne Spitalet Civile	18	16	22	15	7	12	90	100
12	Dergimet jashtë IK per konsultime	260	145	210	138	236	203	1192	1283
13	Dergimet jashte IK per intervenime	31	13	28	18	38	29	157	172
14	Transferet shendetesore	1	0	2	3	2	3	11	22
15	Rastet me TBC	0	0	0	0	0	0	0	2
16	Rastet me HEPATIT B	0	0	2	1	0	0	3	4
17	Rastet me HEPATIT C	0	0	1	1	2	0	4	8
18	Rastet HIV pozitiv	0	0	1	0	0	0	1	0
19	Aplikimi i Testeve Psikologjike	251	146	218	143	163	138	1059	1032
20	Analizat e gjakut sipas planit	104	94	78	78	86	64	504	542
21	Analizat e gjakut sipas indikacioneve	58	36	63	17	31	31	236	372
22	Analizat e gjakut per substancave psikotrope	0	0	0	0	0	0	0	6
23	Vizitat sistematike muojre (parametrave vital)	1496	1427	1428	1429	1486	1563	8829	7621
24	Kontrolltet stomatologjike sistematike	43	26	35	32	160	190	486	298
25	Kontrolltet gjinekologjike sistematike	7	5	2	5	5	6	30	32
26	Mamografi	0	0	0	0	0	0	0	2
27	PAPA test	0	0	0	0	0	0	0	4
28	RTG Pulmo	18	17	15	10	21	15	96	68
29	Neurotic Syndromes	250	201	249	261	282	225	1468	1456
30	Psychotic Syndromes	37	28	34	45	38	33	215	221
31	Semundjet kardiovaskulare	78	60	88	44	90	73	433	417
32	Semundjet Respiratore	199	179	121	90	109	69	767	853
33	Semundjet gastrointestinale	135	98	144	107	114	122	720	647
34	Semundjet urogjenitale	55	88	52	36	45	36	312	272
35	Semundjet e lekures	70	55	80	55	78	67	405	387
36	SS te transmetueshme	0	1	0	3	4	4	12	9
37	Semundjet e sistemit lokomotor	103	69	113	100	112	99	596	623
38	Semundjet infektive	2	1	3	3	7	1	17	29
39	Vete lendimet	17	9	9	21	22	13	91	58
40	Lendimet trupore	31	28	35	30	52	30	206	175
41	Abuzimet seksuale	0	0	0	0	0	0	0	3
42	Rastet ne greve te urise	12	4	5	6	6	8	41	38
43	Tentim vetevrasjet	6	0	5	4	2	1	18	14
44	Vetmia - Izolimi	45	35	33	40	38	20	211	309
45	Vdekjet ne burg	0	0	2	0	1	1	4	2

Tabela numër 1, përmbledhje (6) gjashtëmujore e indikatorëve të aktiviteteve shëndetësore në DShB

Bazuar në këto të dhëna, gjatë kësaj periudhë ka pasur 32,408 vizita mjekësore, krahasuar me 29,905 me po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Janë kryer gjithsejtë 9,315 vizita sistematike, 740 analiza laboratorike, 64 hospitalizime ne stacionar të burgut. Indikatorët e tjerë, kryesisht kanë vlera të njëjta me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur 171 dërgime për institutin e Psikiatrisë Ligjore, 688 referime për QKUK, prej nga janë hospitalizuar 19 pacient.


Daljet jashtë burgut për vitin 2023		
SHSKUKU	FORENZIK	HOSPITALIZIM
688	171	19

Tabela numër 2, Pacientët të cilët janë dërguar jashtë burgjeve për trajtim mjekësorë për gjashtëmujorin e parë të vitin 2023:

Sa i takon indikatorëve të sjelljeve jo të shëndetshëm, të paraqitur ne tabelën numër 3 vërejmë se kemi përqindje të lartë të numrit të përdoruesve të duhanit rreth 70%, drogave mbi 16% me trend të rritjes dhe një numër i konsiderueshëm i të sëmurëve me diabet, hipertension dhe një rast me HIV/AIDS, në burgje:

Raportimi i gjashtëmujorit të parë, për vitin 2023, per disa indikatorëve ne burgje										Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2022	
Nr	Lloji i të dhënave	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i te vizituarve për herë të parë	554	389	475	365	422	345	2,550	100.00	2,449	100.00
2	Numri i duhangjinjeve	403	256	322	261	270	244	1,756	68.86	1,678	68.52
3	Numri i abuzuesve të alkooholit	22	29	45	29	20	13	158	6.20	171	6.98
4	Numri i abuzuesve të drogave	83	74	80	64	59	49	409	16.04	378	15.43
5	Rastet me Hepatitis B	0	0	2	0	0	0	2	0.08	4	0.16
6	Rastet me Hepatitis C	0	0	1	2	2	0	5	0.20	8	0.33
7	Rastet me lendime trupore	26	21	31	20	48	20	166	6.51	150	6.12
8	Rastet me TBC	0	0	0	0	0	0	-	-	2	0.08
9	Rastet me Diabet	23	4	12	10	9	9	67	2.63	49	2.00
10	Rastet me SST (AIDS)	0	0	1	0	0	0	1	0.04	-	-
11	Rastet me Hipertension Arterial	49	24	33	20	31	24	181	7.10	158	6.45

Tabela numër 3, përmbledhje (6) gjashtëmujore e disa indikatorëve specifik të DShB



Graf numër 1, përmbledhje (6) gjashtëmujore e disa indikatorëve specifik të DShB ne graf.

Gjatë këtij gjashtëmujori është kryer raundi i parë monitorimit të punës ne te gjitha njësite tjera shëndetësore te burgjeve, ne përjashtim të NjShB Gjilan dhe Mitrovicë.

Gjithashtu, janë përpiluar raportet e monitorimit, dhe janë marr masa duke ju janë dhënë këshilla ne ato njësi, ku është pare qe janë shkelur procedurat e punës dhe mos respektim i rregullave tjera. Përcjellja e punës është bërë edhe përmes komunikimit dhe raportimit te rregullt ne baza javore e mujore.

Gjatë këtij gjashtëmujori janë lëshuar **20 raporte mjekësore e psikiatrike**, bazuar ne kërkesën e te burgosurve, familjarëve ose avokatëve te tyre.

Është kryer rekrutimi i **15 punëtorëve të ri shëndetësor**, 11 infermierë dhe 2 mjekë qe kanë filluar punën me 1 mars të këtij vit, i në NjShB Dubravë, ndërsa 2 nga këta infermierë, kanë filluar punën në NjShB Gjilan.

Janë kompletuar me kontrata të punës, ID kartela, emaila zyrtare, uniformat për 15 punëtorë të ri. Janë rregulluar koeficientet e punëtorëve, ndërrimet e natës dhe konsultantët janë kalkuluar sipas ligjit te ri të pagave dhe koeficienteve.

Gjithashtu, është ende i hapur konkursi edhe për pozitën **një psikiatër ne burg**, ku pritet qe me datë 17 të këtij muaj, të mbyllet afati për dorëzim te dokumentacionit dhe vazhdim të procedurave te rekrutimit.

Gjatë këtij gjashtë mujori kanë qenë në pushim të lehonisë katër punëtorë.

Është kryer monitorimi dhe hapja e kutive për ankesa të burgosurve në shumicën e njërive shëndetësore të burgjeve, nuk ka pasur ankesa nga ana e burgosurve për stafin shëndetësor të burgjeve.

Menaxhimi kontratave:

Është kryer furnizimi me uniforma për këtë vit, për të gjithë punëtorët e NJSHB.

Furnizimi me material higjienik, është kryer dy herë gjatë kësaj periudhe sipas kërkesave te njërive dhe sipas kontratës.

Material për zyre nuk jemi furnizuar në këtë gjashtë mujor ende nuk kemi kontrata për furnizim.

Dosje mjekësore, protokolle, letër A4 është kryer dy herë gjatë kësaj periudhe.

Kompania Rikon për shfrytëzim të fotokopjeve dhe printerëve është përgjigjur me kohe dhe janë kryer shërbimet sipas kontratës për njësit shëndetësore të burgjeve.

Janë kryer analizat sanitare për të gjithë punëtorët shëndetësor të burgjeve për këtë vite.

Është duke u bërë edhe shpërndarja e Manualit te Parë për Procedura Standarde te Infermierisë në KPSH, në të gjitha njësitë e burgjeve.

*Shpenzimi i buxhetit* ka shkuar sipas planit të rrjedhës së parasë dhe atij të prokurimit. Ka pasur disa vonesa nga disa furnizues, veçanërisht me ata që kanë kontrata me Autoritetin Qendror të Prokurimit. Janë ndërmarrë masat adekuate për tejkalimin e situatës.

Nga raporti i Auditorit të përgjithshëm nuk ka pasur asnjë vërejtje për DShB konkretisht por për disa gabime teknike në proceduara të cilat janë evituar gjatë procesit

Nga Auditimi i brendshëm dhe nga MKPT të IAP kemi pasur vërejtje për asgjësimin e barërave me afat të skaduar. Këtë rekomandim e kemi plotësuar dhe tanimë vetëm pritet asgjësimi pasi që kanë përfunduar procedurat paraprake si ajo e verifikimit të stokut nga IF, kontrata nga DP, janë formuar

komisionet e dorëzimit dhe ka mbetur ekzekutimi i kësaj procedure sipas kontratës valide, tre vjeçare.

Tabela e më poshtme pasqyron shpenzimin e buxhetit që në total i përgjigjet 50% por ka dallime sipas kategorive. Sqarimet janë dhënë në tabelë.

Shpenzimi i buxhetit të DShB, kodi 726, për Vitin 2023, sipas kategorive					
Nr	Kategoria	Buxheti i ndarë për vitin 2023	Shpenzuar deri me 30.06.2023	Perqindja e shpenzimit	Vërejtje
1	Kodi 726; DShB, Buxheti Total	1,777,877.00	880,152.05	49.51	Total buxheti i realizuar
2	NUMRI I STAFIT	140	139	100	
2	RROGA DHE PAGA	1,142,877.00	691,493.73	60.50	Është tejkaluar shuma e parapare si pasojë e mos paraqitjes së shtesave për ndrrime të ntës dhe kujdestari
3	MALLRA DHE SHËRBIME	580,000.00	187,155.54	32.27	Nuk është realizuar më shumë sese nuk ka psur kontrata të cilat tani veç janë nënshkruar dhe disa janë në proces.
4	SHPENZIME KOMUNALE	5,000.00	1,502.78	30.06	Ka pasur kursime.
5	PASURITË JO FINANCIARE - KAPITALET	50,000.00	0.00	-	Është përfunduar dhe ka pasur edhe kursime por pagesa bëhet në muajin gusht sipas plani për rrjedhën e parasë

Tabela numër 4, përmbledhje (6) gjashtëmujore e shpenzimit të buxhetit në burgje

Kanë përfunduar procedurat e tenderimit dhe është bërë liferimi i mallit për kategorinë e kapitaleve. Të gjitha NjShB janë pajisur me RTG digital për stomatologji. Kanë mbetur mjete dhe jemi në proces të ri tenderimit për pajisje shtesë, jashtë planit në dobi të avancimit të shërbimit dhe shfrytëzimit të mjeteve të kursyera në këtë fazë si dhe për kompletimin e laboratorëve me pajisje për të cilat ka reagensë në treg dhe në prodhim.

Janë përfunduar të gjitha procedurat e parapara të tenderimit sipas planit dhe janë nënshkruar kontratat, gjashtë sosh. Janë dy procedura në fazën e vlerësimit dhe një në përgatitje të specifikave sipas planit si dhe një shtesë si rezultat i tepricës së mjeteve në kategorinë e kapitaleve.

#### **Shëndeti mendor në burgje: Shërbimet dhe aktivitete kryera**


Bazuar në planet e punës, strategjitë e brendshme dhe rekomandimet e organizatave monitoruese ndërkombëtare dhe kombëtare shërbimet e shëndetit mendor në burgje edhe në vitin 2023 kanë vazhduar me kryerjen e të gjitha shërbimeve me theks të veçantë në masat e shtuar për detektimin dhe menaxhimin e rasteve me rrezik potencial për vetëvrasje apo vetëlëndim.

Shërbime e shëndetit mendor në burgje, duke përfshirë intervistat e para psikologjike, ekzaminimi i statusit mendor, ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes psikologjike janë ofruar nga psikologët në format të kombinuar, edhe në zyre dhe në blloqe, pavijone e hapësira të përshtatura.

SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDORË TË OFRUARA NË BURGJE		
Tremujori i parë i vitit	Shërbimi	Numri
2023	Konsulta shëndetësore	15363
2023	Vizita psikiatrike	3189
2023	Seanca psikologjike	3907

Tabela numër 5. Shërbimet e shëndetit mendor në kuadër të të gjitha shërbimeve shëndetësore në burgjet e Kosovës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.

## Shërbimet e shëndetit mendor të pasqyruara në përqindje në kuadër të të gjitha konsultave shëndetësore



Grafi numër 2. Shërbimet e shëndetit mendor të pasqyruara në përqindje në kuadër të të gjitha shërbimeve shëndetësore në burgjet e Kosovës në gjashtëmuajt e parë të vitit 2023.

Afro gjysma e shërbimeve shëndetësore, përkatësisht 46.18% e të gjitha shërbimeve mjekësorë të ofruara në burgjet e Kosovës gjatë gjashtëmuajt të parë të vitit 2023 përbëhen nga shërbimet e shëndetit mendor. Vizitat psikiatrike, vlerësimet psikologjike, seancat e psikoedukimit, këshillimit, përkrahjes emocionale dhe psikoterapisë përbëjnë shërbimet kryesore të shëndetit mendor në burgje.

### Shërbimet dhe aktivitetet shtesë

Vlerësimi sistematik dhe koordinimi lidhur me rrezikun e shtuar për vetëvrasje

Bazuar në planin e punës dhe targetet strategjike të DSHB nga stafi i shëndetit mendorë në të gjitha njësitë ka vazhduar vlerësimi intensiv psikologjik për të detektuar rastet e me vështirësi në menaxhimin e gjendjes psikologjike dhe atyre me rrezik për vetëvrasje. Ky vlerësim psikologjik po kryhet në vazhdimësi përmes baterisë së testeve zyrtare të DSHB për vlerësim psikologjik dhe inventarëve të tjera klinike sipas përzgjedhjes së psikologëve.

BATERIA ZYRTARE E TESTEVE PSIKOLOGJIKE	NË DSHB
FUSHA E VLERËSIMIT	MJETI MATËS
Vlerësimi fillestarë dhe i përgjithshëm i gjendjes psikologjike	Pasqyra e Përgjithshme Psikologjike
Vlerësimi i konstrukteve dhe çrregullimeve bazë psikologjike	CORNELL INDEX
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së ankthit	Beck's Anxiety Inventory
Vlerësimi dhe përcaktimi shkallës së depresionit	Beck's Depression Inventory

Tabela numër 6. Tabela e mjeteve zyrtare për vlerësim psikologjik në burgjet e Kosovës

Për rastet urgjente, të cilat në bazë të interpretimit të testeve kanë treguar rrezik të moderuar apo të lartë për vetëvrasje janë dhënë rekomandimet me shkrim për secilin psikolog, bazuar në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimit - 2019/DSHB, dhe në funksion të menaxhimit të menjëhershëm të rasteve. Rastet janë vënë në menaxhim të ekipeve multidisiplinare për menaxhimin e personave me rrezik për vetëvrasje në të gjitha burgjet. Sipas kushteve të përcaktuara në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimit - 2019/DSHB, janë arkivuar në DSHB së bashku me raportet e vazhdueshme të punës së këtyre

komisioneve të emëruara me vendim të përbashkët të udhëheqësve të njërive dhe drejtorëve të burgjeve.

*Aplikimi i terapisë me elemente okupuese me pacientët e krahut psikiatrik në Stacionarin e NSHB Dubravë*  
Në rrethanat e burgut me reduktim të rëndësishëm të lëvizjeve, kontakteve dhe vizitave për të burgosurit, me qëllim të mbështetjes dhe ruajtjes nga dëmi shtesë i aspektit psikologjik të burgosurve në krahun psikiatrik, stafi i NJSHB Dubravë po e mirëmban organizimin e terapisë me elemente okupuese brenda mundësive dhe kushteve teknike dhe logjistike. Këto forma të terapisë janë rekomanduar edhe në raportin e KPT të KE për vitin 2020. Kjo formë e terapisë është mirëmbajtur edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2023.

*Mbështetja e komisioneve multidisiplinare për deradikalizimin e të burgosurve*

Edhe përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 stafi i shëndetit mendor në burgje ka ofruar mbështetjen e vet profesionale dhe të vazhdueshme për komisionet multidisiplinare për deradikalizimin e të burgosurve – veçanërisht në BSL dhe QK Dubravë. Gjithashtu edhe në Janar 2023 një përfaqësues i DSHB ka ndjekë trajnimin për trajner me 4 module në fushën e deradikalizimit, rehabilitimit dhe ri integritimit të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në mbështetje të CDF. Këto njohuri gjatë vitit 2023 do të barten të psikologët e burgjeve.

*Plotësimi dhe avancimi stafit*

Shërbimet e shëndetit mendor në burgje edhe gjatë vitit 2023 janë mbuluar nga dhjetë (10) psikolog klinik me orar të plotë të punës, (2) psikolog klinik konsultant, një (1) psikiatër i rregullt, dy (2) me gjysmë norme dhe shtatë (7) psikiatër konsultant. Po ashtu është i hapur konkursi për një psikiatër në NJSHB.

Dy nga psikologët e DSHB ndjekin e stazhit specilistik në kuadër të specializimit në psikologji klinike të planifikuar e ndarë nga MSH/DSHB. Po ashtu gjatë këtij gjashtëmujori është proceduar dhe është pranuar kërkesa tek bordi për specializime për ndarjen e këtij specializimi edhe për tre psikolog klinik të tjerë që punojnë në burgje në funksion të avancimit profesional të stafit, qëndrueshmërisë së stafit dhe avancimit të shërbimeve të shëndetit mendor në burgje.

Psikologët nga njësi të ndryshme janë angazhuar kohë pas kohe në trajnimet të përbashkëta me SHKK në funksion të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve.

**Sfidat**

*Të paraburgosurit me probleme të shëndetit mendor*

Meqë mund konsiderohet se nga ana e DSHB është siguruar tashmë një stabilitet i stafit të shëndetit mendor, avancimi i tyre profesional si dhe kushtet teknike e logjistike për punë. Sfidë e rëndësishme edhe në vitin 2023 mbetet numri i madh i të paraburgosurve me probleme të natyrës psikike për të cilët gjykata ka lëshuar një urdhër për vlerësim apo trajtim të detyrueshëm në IPFK por në mungesë të vendeve në IPFK mbahen nëpër qendrat e paraburgimit duke e mbingarkuar kështu stafin e shëndetësor në përgjithësi dhe stafin e shëndetit mendor në veçanti.

*Mungesa e supervizionit për ofruesit e shërbimeve të shëndetit mendor*

Supervizioni apo mbikëqyrja profesionale në fushat e shëndetit mendor përfaqëson procesin përmes së cilit profesionisti vazhdimisht merr shërbime personale, nga një supërvajzer me përvojë, me qëllim të ruajtjes së mirëqenës së vet psikologjike e cila është e cenuar vazhdueshëm nga procesi i punës me pacient me problem mendore. Mungesa e një shërbimi të tillë në nivel kombëtar ka pamundësuar një implementim të tij edhe të stafit të shëndetit mendor në burgje duke reflektuar drejtpërsëdrejti edhe në kualitetin e punës dhe mirëqenien e stafit.

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar Programi i Mirëmbajtjes dhe trajtimit të të burgosurve me Metadon. Të dhënat janë paraqitur në tabelën numër 6.

Shpenzimet e Metadonit në burgje në periudhën Janar - Qershor 2023								
Nr	Specifikat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
1	RV Rastet ne Vazhdim	34	29	39	35	36	44	217
2	R Rastet e Reja	2	9	11	10	12	3	47
3	RP Rastet e Perseritura	8	9	5	5	5	3	35
4	RL Rastet e Larguara	15	8	8	10	5	15	61
5	TPz Totali I Pozitive							162
6	Totali I Mililitrave te Shpenzuara							43709
7	Totali I mililitrave te pranuar							43,400

Tabela numër 7. Shpenzimet e Metadonit dhe programi i Metadonit për periudhën 6 mujorit të parë në burgjet e Kosovë

Të dhënat nga DShB lidhur me disa indikatorë, Qershor 2023					
Nr	Institucioni	Indikator			Totali
		Mbi 65 vjet	Me nevoja të veçanta	Sëmundje kronike	
1	NjShB në Dubravë	13	4	102	45
2	NjShB në Gërdovc	11	4	69	28
3	NjShB në Smrekovicë	4	0	23	7
4	NjShB në Prishtinë	7	0	38	76
5	NjShB në Gjilan	2	0	26	7
6	NjShB në Prizren	0	0	6	21
7	NjShB në Mitrovicë	1	1	20	11
8	NjShB në Pejë	1	0	11	12
9	NjShB në QK të Miturve	0	0	0	7
10	NjShB në QK të Femrave	0	0	3	5
11	NjShB në QK të miturve të avansuar	0	0	0	0
12	Perqindja	2.85	0.51	16.97	12.47
13	<b>Totali</b>	<b>32</b>	<b>9</b>	<b>298</b>	<b>219</b>

Tabela numër 8, Disa të dhëna për personat e moshuar, me nevoja të veçanta, sëmundje kronike dhe çrregullime mendore në burgje

### IShTPNV;

Numri i të moshuarave në burgje po rritet gradualisht dhe kjo imponon edhe adoptimin e shërbimeve përkatëse. Në planin strategjik dhe në bashkëpunim me MD/ShKK ka përfunduar projekti për trajtimin e personave me nevoja të veçanta ku janë të përfshirë edhe rastet e moshuara. Është bërë hapja e Institucionit Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta- IShTPNV, i cili përbëhet nga 5 njësi dhe ka kapacitet me rreth 81 vende:

- I. **Njësia për trajtimin e personave me nevoja te veçanta (9 vende);** ku trajtohen të gjitha ata persona që kanë pengesa arkitektonike dhe të tjera shqisore (personat me proteza, karroca invalide, pengesa në të parë dhe të dëgjuar, ata me paterica mbështetëse dhe të gjithë ata që kanë nevojë për mbështetje për funksione vitale).
- II. **Njësia geriatrike (12 vende),** ku trajtohen personat e moshuar që kanë nevojë për mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm). Këto dy njësi do të vendosen në Pavijonin numër 7, i dedikuar për këtë qëllim.



- III. **Njësia për trajtim të shtuar mental (20 vende)**, ku trajtohen personat që kanë rrezik vetëvrasje dhe çrregullime akute, të përkohshme, mendore).
- IV. **Njësia për trajtimin e personave me sëmundje të varësisë, (20 vende)**: ku bëhet trajtimi i sëmundjeve të varësive, trajtimi zëvendësues, terapia okupuese dhe rehabilitimi.
- V. **Njësia për trajtimin e sëmundjeve kronike (20 vende)** ku bëhet trajtimi i personave me sëmundje kronike me kujdes permanent shëndetësor, të monitoruar. Këto tri njësi do të vendosen në Pavijonin D, i dedikuar për këtë qëllim.

Kemi dhënë kontributin tonë në MD për plotësim dhe zbatim të disa rekomandimeve tona për draft ligjet dhe strategjitë zhvillimore të MD, sa i takon trajtimin të dhunuesve në familje, etj.

**Kushtet higjienike sanitare** janë monitoruar në vazhdimësi nga Udhëheqësit e NjShB-ve dhe janë vlerësuar sipas kriterëve nga 0-5 që siç shihet rreth 4.36 ka qenë vlerësimi i përgjithshëm. Është bërë edhe mirëmbajtja higjienike sanitare por edhe DDD në dy tremujorët sipas planit nga OE përkatës i monitoruar nga stafi menaxhues i burgjeve.

Raporti i kontrollës Higjienike në Burgje, Janar - Qershor 2023			Burgjet										Rezultati Final		
Nr	Njësitë	Parametrat specifik që inspektohen	Dubravë	Lipjan 1	Lipjan 2	Lipjan 3	Prizren	Gjilan	Pejë	Mitrovicë	Prishtinë	Smreko vnicë		BSL	
1	Ambulanta	Higjiena	3.83	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.83	5.00	4.83	5.00	5.00	<b>4.86</b>	
2		Mbeturinat mjekësore	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	5.00	4.83	<b>4.86</b>	
3		Barërat pa afat, kontrolli, evidenca	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.33	5.00	4.83	<b>4.92</b>
4		Stacionari, miëmbajtja, qarqafët, higjiena...	4.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	4.00	4.67	5.00	5.00	<b>4.76</b>	
5	Depoja e ushqimit	Gjendja e depos	3.00	4.17	4.17	4.50	4.33	5.00	4.17	4.00	4.33	5.00	4.33	<b>4.27</b>	
6		Temperatura	3.17	4.17	4.17	4.50	5.00	2.33	4.17	5.00	5.00	5.00	4.83	<b>4.30</b>	
7		Skadencia	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	4.83	<b>4.95</b>	
8	Kuzhina	Higjiena	3.00	3.33	3.33	4.00	4.00	3.50	4.00	4.00	4.50	4.33	4.17	<b>3.83</b>	
9		Higjiena e hapësirave	3.00	4.00	3.50	4.67	5.00	3.83	4.00	3.83	4.33	5.00	4.17	<b>4.12</b>	
10		Higjiena e pajisjeve	3.83	4.17	4.00	5.00	5.00	4.00	4.67	3.50	4.33	5.00	4.33	<b>4.35</b>	
11		Higjiena e përpunimit të ushqimit	4.00	4.50	4.00	4.00	5.00	4.83	4.67	3.50	4.83	5.00	4.33	<b>4.42</b>	
12		Kontrolli i cilësise (kualiteti dhe higjiena)	3.00	3.83	3.83	3.83	4.00	4.33	4.67	3.50	4.00	5.00	4.17	<b>4.02</b>	
13		Kontrolli i sasië (kalorive)	4.00	4.00	4.50	4.17	5.00	4.50	4.00	3.50	4.00	3.83	4.33	<b>4.17</b>	
14	Uji i pijes	Marrja dhe ruajtja e mostres (72 orë)	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	4.50	5.00	4.67	4.67	5.00	4.67	<b>4.86</b>	
15		Rrjedhshmëria	4.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	4.67	5.00	4.00	4.00	5.00	<b>4.61</b>	
16	Stafi	Cilësia	4.00	4.83	4.17	5.00	4.00	5.00	4.67	4.00	4.00	5.00	4.17	<b>4.44</b>	
17		Uniformat	4.00	4.00	3.33	5.00	4.00	4.00	3.33	4.00	3.67	2.83	4.83	<b>3.91</b>	
18	Dhomat e banimit	Librezat Sanitare	5.00	5.00	4.67	5.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	4.33	5.00	<b>4.82</b>	
19		Kushtet higjienike sanitare	3.00	4.17	4.17	4.00	3.50	3.83	4.00	5.00	4.50	3.83	4.00	<b>4.00</b>	
20		Ndërrimi i qarqafëve 2 herë në muaj	4.00	4.50	5.00	4.00	3.33	5.00	4.67	4.00	3.67	3.83	4.83	<b>4.26</b>	
21		Ndërrimi i batanijeve çdo 3 muaj	3.00	4.00	4.83	4.67	2.83	4.00	4.67	5.00	3.83	4.00	5.00	<b>4.17</b>	
22		Larja e nërresave çdo javë	3.83	4.17	4.83	5.00	3.33	4.00	4.67	5.00	4.50	5.00	4.67	<b>4.45</b>	
23		Mjetet higjienike personale	3.67	4.00	4.67	5.00	3.50	3.00	4.67	4.00	3.83	4.83	4.50	<b>4.15</b>	
24	Nyjet sanitare	Mjete higjienike të dhomës	3.00	3.17	5.00	5.00	3.17	3.00	4.00	4.00	3.67	4.00	4.33	<b>3.85</b>	
25		Hiigjiena	3.33	4.00	3.50	4.00	3.00	4.00	4.33	5.00	4.00	4.67	4.50	<b>4.08</b>	
26		Uji i rrjedhshëm	4.00	5.00	4.17	5.00	4.00	4.17	4.67	5.00	5.00	4.00	5.00	<b>4.55</b>	
27	Bnjot	Mjetet higjienike	3.33	3.17	4.00	5.00	3.00	4.00	4.67	5.00	5.00	3.83	4.67	<b>4.15</b>	
28		Higjiena	3.00	3.17	4.00	5.00	3.00	3.00	3.67	3.83	4.00	3.83	4.33	<b>3.71</b>	
29		Mjetet higjienike	3.00	3.17	4.00	5.00	3.00	3.17	4.17	4.17	4.00	3.50	4.17	<b>3.76</b>	
30		Uji i rrjedhshëm	3.00	5.00	4.67	5.00	4.00	4.00	4.67	4.83	5.00	4.00	5.00	<b>4.47</b>	
31	DDD	Frekuenca e larjes sipas specifikave	3.00	4.83	5.00	5.00	3.33	5.00	4.67	4.33	4.00	4.00	4.50	<b>4.33</b>	
32		Dezinfektimi ditor	3.00	5.00	5.00	5.00	4.00	5.00	4.33	5.00	5.00	2.83	4.67	<b>4.44</b>	
33	Tjera	DDD e rregullt periodike, çdo 3 muaj	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00	<b>5.00</b>	
34			-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
35			-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
36			-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Mesatarja e vlerësimit të kushteve higjienike sanitare në burgje, (vlerat matëse nga 0 - 5)														<b>4.36</b>	

Tabela numër 9, monitorimi i kushteve higjienike sanitare në burgje nga Udhëheqësit e NjShB-ve;

### **Barërat:**

Gjate këtij gjashtë mujori, është kryer monitorimit i punës tek të gjitha NJShB të Burgjeve Në ndërkohë është përcjellë puna e tyre me raportime të rregullta mujore si dhe evidentimi i shpenzimeve ditore nga Kryeinfermierët përkatësisht përgjegjësit e barnatoreve doracake të këtyre njësisve dhe janë dhe rekomandimet përkatëse

Nga të gjitha Burgjet iu është kërkuar të bëhen kërkesat për këtë periudhë për furnizim me barna, gjë që ka përfunduar në këtë gjashtëmujor. Porositja e barnave është bërë sipas kërkesës së qendrave dhe po ashtu është bërë edhe distribuimi nga depoja qendrore në QK.Lipjan nëpër të gjitha qendrat tjera. Procesi ka shkuar në rregull.

Është bërë regjistrimi i të gjitha barnave me afat të skaduar, janë të evidentuara në forma elektronike dhe manuale sipas rekomandimeve të IF dhe jemi në përfundim e sipër për asgjësimin e tyre sipas procedurave konkurruese. Është bërë zotimi i mjeteve (7,000.00 €) nga 10,800.00 të planifikuara me kontratës.

Janë të përfunduara të gjitha procedurat e prokurimit sipas planifikimit të bërë. Është nënshkruar kontrata për këto procedura:

1. Furnizim me barna
2. Furnizim me preparate stomatologjike
3. Furnizim me material shpenzues mjekësor
4. Asgjësimi i barnave me afat të skaduar për NJShB

Janë bërë përgatitjet për fillimin e SMSF, janë mbajtur disa takime me përgjegjësit nga MSH dhe kemi mbetur që ne fillimin e muajit Korrik veçse të regjistroheshin kontratat e para

Servilizmi i pajisjeve laboratorike është duke shkuar sipas planifikimit dhe me këtë edhe Laboratorët doracake janë në funksion

Menaxhimi i kontratave:

Këtë vit, janë nënshkruar tri (3) kontrata të reja për DSHB. Të gjithë OE e kanë respektuar kontratën dhe nuk kemi vërejtje.

Kemi pasur përfundimin e dy (2) kontratave. Të gjitha kontrata janë të regjistruara në e-prokurimi dhe menaxhimi i tyre ka filluar të bëhet me këtë sistem.

Për momentin DSHB, për shërbime Farmaceutike, gjithsej ka të lidhura pese (5) kontrata me operatorë ekonomik.

Furnizimet dhe Shpenzimet:

Të gjitha NjShB-të janë furnizuar sipas kërkesës deri në momentin e raportimit, kërkesa për gjashtëmujorin tjetër është veçse duke u përpiluar sipas planifikimit paraprak dhe sipas buxhetit të planifikuar.

Duke u bazuar në raportet e NjShB-ve lidhur me shpenzimet e barnave, ju informojë se vlera e shpenzimeve të barnave në total për të gjitha burgjet është: **56,574.55 €\***

- DSHB ka pasur mungesë të barnave në këtë periudhë, meqenëse nuk kemi pas kontratës për furnizim me barna pothuajse një vit. Kjo çështje është ende në proceduar por në ndërkohë, është realizuar një kontratë emergjente me kohëzgjatje për 18 muaj për të plotësuar zbrazëtirën deri në përfundim të proceduarve. Për momentin ka mjaftueshëm barëra.

- Nuk janë të llogaritura shpenzimet e materialit shpenzues mjekësor, produktet stomatologjike, pajisjet e imëta mjekësore dhe laboratorit.

Nr.	Njësia Shëndetësore e Burgjeve	Shuma gjashtëmujore të parë e shpenzimit (€)
1.	NjShB - Dubravë	16,544.44
2.	NjShB - BSL	8,771.41
3.	NjShB - Smrekonicë	4,392.49
4.	NjShB - QKM	1,146.16
5.	NjShB - Prishtinë	9,224.92
6.	NjShB - Prizren	3,228.99
7.	NjShB - Gjilan	6,806.55
8.	NjShB - QKF	2,123.41
9.	NjShB - Pejë	2,043.16
10.	NjShB - Mitrovicë	1,961.49
11.	NjShB - QEK	330.43

Tabela numër 10 Shpenzimet sipas NjShB-ve me barëra për këtë gjashtë mujor;

Është bërë edhe furnizim me një sasi të vogël të barnave me vlerë prej **1,392.00 €** nga DF/MSh deri sa është lidhur kontrata me OE.

Nga kodi buxhetor 13630 i ndarë për shërbime farmaceutike të parapara janë 90,000.00, ku nga këto janë shpenzuar 69,951.22 në barna dhe 7,000.00€ janë zotuar për asgjësimin e barnave.

Ka pasur vështirësi për të vazhduar praktika e mirë e qëndrueshmërisë së furnizimit me barëra në të gjitha njësitë. Vështirësi ka pasur në proceduar të tenderimit dhe prokurimit si dhe çështje të ankimimit të dy anshme si dhe të mungesat në sektorin publik ku DShB është detyruar të mbuloj furnizimet edhe për këto institucione për pacientët e burgosur, përkundër faktit se ato institucione janë përgjegjëse për këtë çështje.

*SISh;*

Gjatë këtyre gjashte muajve janë mbajtur tri takime për përgatitje të planit për zbatim të SISh dhe SMSF.

Në takimin e parë është diskutuar për të përgatitur planin dhe ekipet e të dyja shërbimeve për vazhdim të aktiviteteve për zbatim SISh, në tri komponentë :

1. SMSF, evidenca e barërave ne mënyrë elektronike dhe sipas sistemit,
2. Menaxhimi elektronik i dosjeve mjekësore,
3. Menaxhimi i stafit dhe dosjeve personale ne mënyrë elektronike.

Janë dërguar listat e barërave të DShB për futje në SMSF sipas rekomandimeve, si dhe listat për programin e SMSF me personat përgjegjës ne DSHB dhe në NJShB.

Takimi i dyte i mbajtur ka qene edhe me OE "Dataprognat" ku ka prezantuar proceset e punës me sistem dhe jemi njoftuar që janë krijuar listat e produkteve që i ka DShB, përveç listës së barërave pasi ka mbet te plotësohen disa të dhëna sipas listës së tyre në sistem dhe prerja e stokut për regjistrim e gjendjes fillestare.

Ne sistem është regjistruar hierarkia e DSHB- së dhe stafi përgjegjës sipas njësive shëndetësore.

Në takimin e tretë, të mbajtur po ashtu ka qenë edhe OE për sistemin e SMSF - se, është diskutuar për implementimi i sistemit të menaxhimit të stokut farmaceutik në DShB dhe në njëmbëdhjetë njësitë shëndetësore.

Fillimisht është futur në sistem lista e DShB në SMSF së bashku me OE "Dataprognit" sipas listës me specifika të tyre dhe pastaj do të behet regjistrimi i stokut në sistem, nga stafi i NjShB-ve në prezencë të OE në mënyrë që të verifikohet zbatueshmëria e plotë me të gjitha specifikat.

### **Projekti i Këshillit të Evropës**

*"Përmirësimin e trajtimit për personat e privuar nga liria"*

Projekti do të zgjasë për 36 muaj (ka filluar në tetor 2022 dhe përfundon në shtator 2025) dhe do të kushtoj 850,000.00€.

Qëllimi i tij do të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

1. forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e konsistencës dhe bashkërendimit të qasjeve të të gjithë aktorëve përkatës në mënyrë që të përmirësohet kujdesi shëndetësor i ofruar për të gjithë personat që janë de facto dhe de jure të privuar nga lirinë e tyre, duke përfshirë personat e dënuar, pacientët e shtruar në mënyrë të pavullnetshme në spital psikiatrik dhe personat me aftësi të kufizuara mendore të vendosur në institucionet e mirëqenies sociale;
  2. përmirësimi i mëtejshëm i performancës profesionale të Departamentit të Shëndetësisë në Burgje (DShB) në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë përmes masave për ngritjen e kapaciteteve, duke vendosur protokolle përkatëse dhe duke forcuar masat mbrojtëse kundër keqtrajtimit;
  3. rishikimin e legjislacionit dhe politikave që rregullojnë shtrimin në spital të pavullnetshëm psikiatrik në dritën e standardeve të KE dhe vlerësimin dhe rishikimin e procedurave dhe informacionit që u jepet pacientëve mbi të drejtat e tyre; dhe
  4. forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të pacientëve të paraburgosur me aftësi të kufizuara mendore dhe lehtësimin e rehabilitimit dhe riintegritimit të tyre në shoqëri.
- Pavarësisht përmirësimeve dhe rezultateve shumë të mira të arritura në kuadër të projektit të Lehtës Horizontale 2016-2018, kërkohet ende një kontribut i rëndësishëm për të përmbushur objektivat e reformës dhe për të shkaktuar ndryshime afatgjata në praktikë.

Një nga pikat kryesore të projektit të mëparshëm ishte suksesi i arritur nga DShB, përkatësisht zhvillimi i Procedurave Standarde të Operacionit (SOP), i cili lehtësoi transferimin e sistemit të kujdesit shëndetësor të burgjeve nga Ministria e Drejtësisë (MD) në Ministrinë e Shëndetësisë. (MSH), duke përfshirë plane specifike veprimi, që synojnë të sigurojnë ankesës të barabartë në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe trajtim siç ofrohet nga sistemi i rregullt publik, i cili u finalizua dhe u publikua në tetor 2017.

PSO mbetet një nga parimet drejtuese të profesionistëve të kujdesit shëndetësor të burgjeve në të gjithë vendet e paraburgimit në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar tri Vlerësimi nga ekspertët ndërkombëtar përfshirë atë të pozitës së DShB, shëndetin mendor në burgje, terapinë okupuese. Vlerësimi ka qenë i saktë deh përfshinë të gjitha vështirësitë që duhet përmirësuar në projekt.

Për të plotësuar Rekomandimet nga Vlerësimet, janë mbajtur 5 punëtori ku si produkte janë plotësuar PSV-të, është shkruar PSV për ISHTPNV dhe është në proces PSV për terapinë okupuese për burgje.

Gjatë kësaj periudhe, janë mbështetur edhe IPFK dhe i SSh nga stafi i DShB për të përpiluar PSV-të e ngjashme me ato të DShB për këto institucione, duke përdorur përvojën e këtij stafi në funksion të zbatimit të Rekomandimeve të KPT të KE.

Raportet me ShKK kanë qenë të shkëlqyeshme në menaxhimin e përbashkët të çështjeve si në nivelin me drejtorë të burgjeve ashtu edhe me Drejtorinë e ShKK dhe vet MD-në.

Ka vazhduar bashkëpunimi i mirë me IAP dhe me MKPT të IAP lidhur me monitorimin e rasteve të veçanta, mbështetjen tonë në komunikim me institucionet e drejtësisë për mënyrën e menaxhimit të rasteve vështirë të mënaxhueshme si dhe janë organizuar disa tryeza me këta faktorë. Bashkëpunim ka pasur edhe me institucionet dhe organizatat e tjera monitoruese.

### ***Vështirësitë:***

Gjatë kësaj periudhe ka pasur vështirësi, siç janë:

1. Kemi pasur largim të stafit mjekësor nga burgjet, disa mjek, specialist dhe psikolog si rezultat i pakënaqësisë më kushtet e punës, pagën dhe mungesën e rrezikshmërisë, marrë parasysh specifikat e punës dhe natyrën e ballafaqimeve.
2. Stafi jo i mjaftueshëm për mbulimin e të gjitha shërbimeve të domosdoshme.
3. Mungesa edhe e dy autoambulancave për transportin e të burgosurve në nevojë.
4. Vështirësi të tjera në realizimin e detyrave si pasojë e integritetit të plotë në kuadër të shërbimeve të ndryshme të MSh-së dhe shpesh herë mungesë e të kuptuarit dhe përkrahjes së specifikave të punës që ka shëndetësia në burgje. Kohëve të fundit nuk kemi informata të mjaftueshme lidhur me proceset strategjike dhe legislative të MSh-së e kjo si pasojë do të mund të krijoj vështirësi në zbatimin e tyre si dhe në mos paraqitjen real të shërbimit në këto dokumente duke mos marrë parasysh specifikat e këtij shërbimi.
5. Në funksion të transparencës së mjaftueshme, të gjitha aktivitetet i kemi publikuar në faqe të Ministrisë. <https://msh.rks-gov.net/Department/Index/10?type=1>;
6. Vështirësi në furnizime me barërë si pasojë e proceduarve të prokurimit dhe ankimit si dhe mos p[ërfillje e mjaftueshme e specifakeve të shërbimit dhe mënyrës së furnizimit të përcaktuar në UA05/2014 të QRK.
7. Mungesa e kapaciteteve të IPFK dhe institucioneve të tjera për trajtimin e rasteve specifike, veçanërisht atyre të shëndetit mendor për ekspertizë dhe trajtim të detyrueshëm psikiatrik.
8. Vështirësi të trajtimit të rasteve psikiatrike që nuk kanë urdhëresë nga gjykatat për trajtim në Klinikën e Psikiatrisë, vështirësi e të kuptuarit se i burgosuri ka të drejtë trajtimi si çdo qytetar tjetër në secilin institucion që ka specifikat për atë trajtim dhe jo referimi i tyre në institucione të tjera.

### ***Synimet:***

DShB ka synime që në vazhdimësi të arrijë këto qëllime:

1. Vazhdimi i ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje dhe qëndrueshmëria e saj përmes trajnimeve, monitorimeve dhe krijimit të kushteve për shërbime cilësore.
2. Vazhdimi i krijimit të kushteve adekuate të favorshme për stafin mjekësor për punën në burgje konform UA 05/2014 dhe Rekomandimeve të Këshillit të Evropës, rregullave Evropiane të Burgjeve dhe Udhërrëfyesve të OBSH-së, përfshirë pagën e dinjitetshme, rrezikshmërinë dhe beneficione të tjera në funksion të qëndrueshmërisë së stafit në burgje.
3. Zbatimi i plotë i protokolleve, procedurave, hapësirave të punës dhe pajisjeve për punë në Njësitë shëndetësore të burgjeve konform standardeve të MSh-së dhe BE-së.

4. Vazhdimi i furnizimit të qëndrueshëm në të gjitha institucionet me barëra dhe material mjekësor.
5. Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve higjienike sanitare në të gjitha institucionet korrektuese dhe kujdesi higjienik e sanitar i përhershëm përmes DDD dhe formave tjera higjienike si dhe ngritjen e njohurive mbi rëndësinë e higjienës personale në burgje.
6. Bashkëpunimi dhe trajnimi specifik i organeve monitoruese të shërbimeve shëndetësore në burgje përmes trajnimit adekuat, profilizimit dhe ndikimit në ngritjen e cilësisë së shërbimeve.
7. Rritjen e bashkëpunimit me shërbimet e tjera të MSh-së në funksion të integritit të plotë të shërbimeve në kuadër të sistemit shëndetësor publik. Tejkalimi i neglizhencave dhe arritjen e synimit që shërbimet e MSh-së të kuptojnë më shumë specifikat dhe rëndësinë e plotësisë të shërbimeve shëndetësore në burgje përmes mbështetjes së vazhdueshme në çdo sferë.
8. Vazhdimi i përpjekjeve për adresimin e çështjeve në Ligjin për shëndetësi dhe sigurime shëndetësore si dy ligje bazike ku përcaktohet pozita e shërbimeve shëndetësore në burgje dhe mënyra e financimit të shërbimeve për të burgosur, ku fatkeqësisht në asnjërin grup nuk jemi pjesë e punës për të dhënë kontributin direkt. Në të njëjtën situatë është edhe Ligji për shëndetin mendor që atakon drejtë për së drejti pjesë të caktuar dhe shumë të ndjeshme të shëndetit të të burgosurve dhe specifikave të tyre.
9. Trajtimin me kujdes të rasteve specifike, të ndjeshme dhe multi nacionale në funksion të garantimit të respektimit të të drejtave të njeriut dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe besimit në shërbim.

Në vazhdimësi do të iu mbajmë të informuar lidhur me gjendjen shëndetësore të të burgosurve dhe aktivitete e ndërmarra, bazuar në planin e punës dhe PSV-të për trajtimin shëndetësor të të burgosurve.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Me respekt!